



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS

Adresa "Sheshi Skenderbej" lagj.Nr.5

www.kukesi.gov.al

tel/fax 0242 (2) 5110

Nr. 54 Prot.

Kukes me, 26.06.2017

KONTRATE

REF-72314-03-16-2017

Kjo kontrate lidhet, mes paleve te meposhtme:

BASHKISE KUKES, e njohur si person juridik ne baze te ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore", me Nr. Identifikimi Tatimor NIPT-i **K5/829201E**, me adrese "Sheshi Skenderbej" Lagjia Nr.5 - Kukes, te perfaqesuar nga Kryetari z.**Bashkim Shehu**

dhe

SUBJEKTIT "G.P.G. Company" sh.p.k, e njohur si person juridik, i regjistruar prane organeve tatimore me Nr. Identifikimi NIPT-i **J64324443V**, i pajisur me license profesionale Nr.NZ.2309/12, me seli ne adresen Lagjia "18 Tetori" godine 1-kateshe tek nyja e prodhimit te asfalto-betonit prane rotundos se Plukut-Lushnje, te perfaqesuar nga Administratori z.**Paqsor Buzi**


OBJEKTI:"Sistemim-Asfaltim i unazes veriore te qytetit Kukes, karburanti i vjeter-stacioni Morin"

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.139/2015, i miratuar me date 17.12.2015"Per veteqeverisjen vendore", ligji Nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", ligji Nr.44/2015, i miratuar me date 30.04.2015 "Kodi i Proç. Administrative ne RSH", ligji Nr.8402, date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" neni 8 (i ndryshuar),VKM Nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores - Per sigurine ne kantier", ligji Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik"(i ndryshuar), neni 58, VKM Nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" nenet 70, 76,77, udhezimi Nr.2, date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit", udhezimi Nr.1, date 16.06.2011, vendimi i KZHR-se Nr.8, date 13.02.2017, Urdheri i Prokurimit Nr.117, date 16.03.2017 "Per fillimin e procedures se prokurimit me objekt: "Sistemim-Asfaltim i unazes veriore te qytetit Kukes, karburanti i vjeter-stacioni Morin", si dhe kerkesat e percaktuara ne shtojcen Nr.17 te DST-se,

Secila pale siguron palen tjeter se ajo ka te drejte dhe fuqi te plote juridike qe te hyje ne kete kontrate dhe se kjo kontrate perben nje dokument legal dhe te vlefshem.

Neni 1
Perkufizime

"Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis AK dhe Kontraktuesit që përbëhet nga të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.



“Çmimi kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.

“Kontraktor” do të thotë personi juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate do të kryejë shërbimin objekt prokurimi.

Neni 2

Qëllimi i Kontrates

Ne kuader të programit buxhetor “*Infrastruktura Vendore dhe Rajonale*” me vendimin e KZHR-se Nr.8, date 13.02.2017, është miratuar projekti me objekt: “*Sistemi-Asfaltim i unazës veriore të qytetit Kukes, karburanti i vjetër- stacioni Morin*” me cikël zbatimi 2017-2018 në shumën totale prej 97.247.799 leke, ku për vitin 2017 është alokuar fondi në shumën - 29.174.340 leke

Qëllimi i kësaj kontrate është kryerja e punimeve civile nga sipërmarrësi që është shpallur fitues në përputhje me dokumentat e tenderit, me financimin e investitorit.

- a. Të gjitha punimet civile sipas kësaj kontrate do të kryhen në përputhje me kërkesat teknike, komerciale dhe operacionale që përcaktohen nga investitori dhe sipas grafikut të punimeve.
- b. Veprimtaria e punës si dhe afatet e dorëzimit të tyre do të paraqiten të përshkruara me hollësi në dispozitat e kësaj kontrate.

KREU I

ÇMIMI I KONTRATES DHE AFATI I REALIZIMIT TË PUNIMEVE

Neni 3

Vlera e Kontrates

Çmimi i kontrates është sipas ofertës së paraqitur nga subjekti në ofertën e tij të datës 17.04.2017, si më poshtë vijon:

Emertimi	Çmimi (leke)
“Sist.-Asfaltim unazës veriore të qytetit Kukes, karburanti i vjetër-stacioni Morin”	78.322.250
Fondi Rezervë 2%	1.566.445
Shuma	79.888.695
TVSH 20 %	15.977.739
Çmimi i pagueshëm:	95.866.434

Kontraktorit do t’i mbahet një fond garancie prej 5 %, për një periudhë 1-vjeçare nga data e aktit të kolaudimit të punimeve, për tu përdorur për riparimin e defekteve brenda kësaj periudhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Neni 4

Çmimi i kontrates

Çmimi i lartpërmendur përfshin çdo kosto dhe shpenzim që është përballuar nga Kontraktori me qëllim të përmbushjes së objektit të kontratës.



[Handwritten signature]

- a. Pagesa per kryrjen e punimeve do te disbursohet perkundrejt kerkeses se Kontraktorit, e cila shoqerohet me dokumentacionin perkates. Pagesa do te kryhet me transferte bankare ne llogarine rrjedhese te subjektit prane Raiffeisen Bank Dega Lushnje, Nr. llogarie ALL 0008 574 533 (leke).
- b. Financimi i punimeve te kryera do te behet me paraqitjen e situacionit te punimeve nga mbikqyresi i punimeve, drejtuesi teknik dhe drejtuesi ligjor.

Neni 5

Garancia per sigurimin e kontrates

Me nenshkrimin e kontrates, Kontraktori bllokun ne forme garancie ne favor te investitorit 10 % te vleres se kontrates, shume e cila do te çlirohet vetem me miratimin me shkrim te investitorit drejtuar kompanise se sigurimit/bankes qe e mban kete garanci, pasi investitori te kete kryer kolaudimin e punimeve.

Neni 6

Afati i zbatimit te kontrates

a). Afati i realizimit te kontrates fillon nga momenti i dorezimit te sheshit te ndertimit deri me date 31.12.2018.

- *Subjekti ne rast vonese te dorezimit te projektit tej afatit te percaktuar, duhet t'i paguaje AK-se, për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.*


b). Gjithashtu subjekti gjate zbatimit te projektit duhet marre te gjitha masat per krijimin e funksionimin normal te levizjes se lire te automjeteve, per arsye se segmenti rrugor ku do te behet investimi, korrespondon me unazen e qytetit dhe perfshin pjesen veriore te qytetit te Kukesit qe lidhet me aksin rrugor kombetar "Ura e Drinit te Zi - Krume" dhe segmentin rrugor qe lidhet me autostraden me drejtim te Pikes se Kalimit Kufitar (PKK) Morin.

- *Ne kete segment rrugor, levizin mjetet e tonazhit te rende, te transportit publik te udhetareve dhe mallrave, me destinacion Kosoven dhe Bashkine Has.*
- *Ky aks rrugor eshte segmenti i vetem i cili lidh Bashkine Has me qytetin Kukesit si dhe me destinacion Tiranen.*
- *Gjithashtu ne shtrirjen gjatesore te ketij aksi, ben pjese rruga e tregut industrial, ushqimor dhe agro-ushqimor te Bashkise Kukes si dhe njekohesisht ushtrojne aktivitetin e tyre me dhjetera biznese te fushave te ndryshme.*

Neni 7

Garancia per sigurimin e kontrates

Me nenshkrimin e kontrates, Kontraktori bllokun ne forme garancie ne favor te investitorit 10 % te vleres se kontrates, shume e cila do te çlirohet vetem me miratimin me shkrim te investitorit drejtuar kompanise se sigurimit/bankes qe e mban kete garanci, pasi investitori te kete kryer kolaudimin e punimeve.



KREU II ZBATIMI I KONTRATES

Neni 8

Garancia per cilesine e punimeve

Kontraktori garanton gjithashtu se edhe punimet anesore do te jene ne perputhje te plote me kerkesat dhe cilesine e punimeve kryesore.

Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit (DST).

- a. Kontraktori i permbahet garancise se percaktuar pas dorezimit te punimeve sipas kerkesave ligjore.
- b. Te siguroje te gjithë materialet qe nevojiten per kryerjen e punimeve, te cilat duhet te jene me cilesi te mire duke plotesuar kerkesat e projektit te zbatimit.

Neni 9

Bashkepunimi me Autoritetin Kontraktor

Kontraktori ka per detyrë të informojë në mënyrë të vazhdueshme Autoritetin Kontraktor - Bashkine Kukës, lidhur me ecurinë e projektit .

- a. Informimi përfshin njohjen me dokumentacionin teknik të administruar gjatë projektit, çdo lloj raporti apo relacioni lidhur me projektin dhe zbatimin e tij.
- b. Drejtuesi i Kantierit i sigurojnë përfaqesuesve të Autoritetit Kontraktor, aksesin e duhur në objektet e kantierit të ndertimit dhe i ve në dispozicion dokumentacionin e zbatimit projektit të mbajtur gjatë gjithë fazave të tij.
- c. Mbikqyresi i Punimeve ka të drejten ligjore të kontrollit të punimeve në objekt gjatë zbatimit të tyre dhe në rast konstatimi të shkeljeve të K.T.Z. informon Autoritetin Kontraktor për korrigjimin deri në ndërprerjen e punimeve.

Neni 10

Modifikimet e shtesat ne projekt

Investitori mund të kerkoje me shkrim ndryshime të arsyeshme të projektit, zerave, vellemeve të punimeve apo të ndonjë pjese të tyre. Kontraktori duhet t'i permbushe ato pa kerkuar qe të ndryshohet kontrata dhe afati i saj.

Neni 11

Pranimi i Punimeve

Me mbarimin e afatit të kontrates, Kontraktori njofton Investitorin për marrjen në dorezim të objektit dhe investitori pasi e kontrollon atë e merr në dorezim në praninë të përfaqesuesit të Kontraktorit. Në qoftë se nga kontrolli punimet rezultojnë në rregull, Investitori i leshon Kontraktori *Çertifikaten e Pranimit*. Në qoftë se nga kontrolli rezulton se punimet nuk janë bërë në rregull në përputhje me kushtet e percaktuara në këtë kontratë, kjo duhet të konfirmohet me një çertifikatë që Investitori i dorezon Kontraktorit.



[Handwritten signature] 4

Neni 12

Mbikqyresi i Punimeve

Eshte personi/grupi i personave te caktuar nga Autoriteti Kontraktor konform procedurave ligjore ne fuqi, te cilet jane pergjegjes per ndjekjen e punimeve te zbatimit si dhe per administrimin e kontrates.

- a. Kontraktori duhet te njoftoje Mbikqyresin e Punimeve per ngjarje te veçanta/rrethana te caktuara te cilat mund te ndodhin ne te ardhmen dhe mund te ndikojne ne cilesine e punimeve/sherbimeve, te rrisin çmimin e kontrates.
- b. Kontraktori ne fillim te çdo muaji do t'i paraqese per miratim Mbikqyresit te Punimeve, **Relacionin** e azhornuar te punimeve te kryera si dhe **Planin Mujor** te punimeve apo sherbimeve qe perfshijne zerat e meposhtem:
 - Mbikqyrësi i Punimeve do te kontrolloje punen e kontraktorit dhe te njoftoje ate per çdo defekt qe mund te gjeje gjate verifikimit. Sa here jepet njoftim per defekte, kontraktori do te beje riparimin e tyre brenda periudhes se specifikuar ne njoftimin e Mbikqyresit te Punimeve.
 - Mbikqyresi i Punimeve do te kontrolloje situacionin mujor dhe do te çertifikoje shumen qe do t'i paguhet kontraktorit
 - Vlera e punes se kryer do te perfshije vetem vleren e sasive te zerave te punes te paraqitura ne preventiv te kryera nga kontraktori dhe te konfirmuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Neni 13

Dënoncimi i te metave te vepres dhe ndreqja e tyre

Investitori njofton Kontraktorit per deformimet apo veset e punimeve qe mund te shfaqen brenda 1(nje) muaji nga data e leshimit te çertifikates se pranimit dhe te pakten brenda 10 (dhjete) diteve nga data e konstatimit te tyre.

Nuk kerkohet njoftim kur Kontraktorit i jane bere te njohura nga mbikqyresi i investitorit gjate zbatimit te projektit ose kur ai i ka fshehur qellimisht ato.

Defektet do te ndreqen me shpenzimet e Kontraktorit. Koha e ndreqjes se defekteve gjate kohes se garancise eshte:

- *Per defektet e renda 4 (kater) dite. Fakti nese defektet jane ndrequr ose jo shenohet ne proces-verbalin e nenshkruar nga Investitori dhe Kontraktori.*
- *Defektet e lehta 2 (dy) dite. Fakti nese defektet jane ndrequr ose jo shenohet ne proces-verbalin e nenshkruar nga Investitori dhe Kontraktori.*

Neni 14

Nënkontraktimi

Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marreveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.



[Handwritten signature] 5

- a. Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë AK për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e N/Kontraktorit.
- b. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë Kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- c. Çdo N/Kontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP). Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për punët që do të kryejë. Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.
- d. Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 15

Mbarimi i Kontrates

Kontrata mbaron në ditën kur janë plotësuar të gjitha detyrimet nga të dyja palët.

- a. Kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor një kopje të proces-verbalit të punimeve të fshehta, librezën e masave, akt-marrjen në dorëzim si dhe situacionin përfundimtar të punimeve, etj.
- b. Dorëzimi i objektit në teresinë e tij, përfshin gjithashtu dhe heqjen e mbeturinave ashtu edhe pastrimin e territorit përreth.

Neni 16

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit


Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

- a. Nëse Autoriteti Kontraktor (AK) është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.
- b. Autoriteti Kontraktor (AK) mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit.
- c. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor (AK) duhet t'i japi Kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes. Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.
- d. Autoriteti Kontraktor (AK) mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, duhet të njoftojë menjëherë AK me shkrim për vonesën si dhe shkakun.

Neni 17

Forca Madhore

Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mos-plotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në



= *[Handwritten Signature]* 6

batim ose ndonjë dështim tjetër ne permbushjen e detyrimeve të tij sipas kontrates, vijne si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

- a. Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- b. Nëse ndodh ndonjë situatë e "Forcës Madhore", Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor.

Neni 18

Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve

Ne qofte se Kontraktori nuk e dorezon objektin te perfunduar brenda afatit te shprehur ne nenin 6, ai detyrohet te paguaje sanksion sipas vlerave perkatese te percaktuara ne kete kontrate per çdo dite vonese.

Neni 19

Zgjidhja e parakohshme e kontrates

Investitori ka te drejte te zgjidhe kontraten ne menyre te njeanshme kur:

- a. Kontraktori nuk i kryen te gjitha punimet brenda afatit te kontrates apo brenda kohes shtese qe mund t'i kete dhene investitori.
- b. Kontraktori nuk ploteson detyrimet qe rrjedhin nga kjo kontrate.
- c. Kontraktori ne rrethanat e mesiperme, nuk i rregullon gabimet e tij brenda nje periudhe 5(pese) ditore, pasi ka marre njoftimin me shkrim nga investitori ose brenda afatit te ri qe investitori ai ka autorizuar me shkrim.

Per arsye objektive investitori mund te zgjidhe kontraten duke njoftuar me shkrim Kontraktori 5 (pese) dite me pare.

- Ne kete rast ai nderpret punimet menjehere, siguron vendin e ndertimit dhe lagohet nga kantieri brenda 5 (pese) diteve nga njoftimi i investitorit dhe njekohesisht punimet e kryera konfiskohen nga investitori.
- Ne rast se investitori e zgjidh kontraten pjeserisht, investitori mund te kerkoje, punime te njejta me ato te pakryera nga sipermarresi dhe sipermarresi do t'i detyrohet investitorit per çdo tejkalim te kosos se ketyre punimeve.

KREU III

DETYRIME TE VEÇANTA TE PUNEDHENESIT

Neni 20

Garantimi i sigurisë dhe mbrojtja e shëndetit te punonjesve

Kontraktori ka per detyre të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me kërkesat specifike të percaktuara ne ligjin Nr.10 237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin



[Handwritten signature] 7

punë” si dhe ligjin Nr.5/2014 të miratuar me datë 30.01.2014 për punë
konventës C 167 të ILO-se, Për sigurinë dhe shëndetin në ndërtim, 1988”

- a. Kontraktori detyrohet të sigurojë mbrojtjen e punëmarrësve në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë.
- b. Kontraktori nuk shkarkohet nga përgjegjësia edhe në rastet kur ai kontraktton persona jashte stafit të tij, për kryerjen e shërbimeve të specializuara

Neni 21

Zbatimi i rregullave të sigurisë në kantierin e ndërtimit

Kontraktori ka përgjegjësinë kryesore për veprimtaritë e përgjithshme të kantierit të ndërtimit, si dhe është përgjegjës për kordinimin e masave të përcaktuara të sigurisë dhe shëndetit.

Kontraktori gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit duhet të:

- a. Marrë masat paraprake për të siguruar që të gjitha vendet e punës të jenë të sigurta dhe pa rrezik dëmtimi ndaj sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve.
- b. Sigurojë mjetet e përshtatshme për t'u mundësuar punonjesve të tij, që të përdorin pajisjet mbrojtëse individuale dhe të garantojë përdorimin e duhur të tyre.
- c. Marrë masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë, mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin në rastet kur ka rrezik për të ndodhur ngjarje.
- d. Marr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve e të personave të tjerë të pranishëm.

Neni 22

Informacioni dhe trajnimi

Kontraktori ka për detyrë të informojë punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre, si dhe çdo person tjetër që ndodhet në vendin e punës, mbi risqet e mundshme dhe masat që merren për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.

Kontraktori konsultohet me punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, pasi punëtorët duhet:

- a. Të informohen në mënyrë të mjaftueshme për rreziqet ndaj sigurisë dhe shëndetit, ndaj të cilave ata mund të ekspozohen në vendin e tyre të punës.
- b. Të instruktohen dhe trajnohen në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për parandalimin, kontrollin dhe mbrojtjen kundër këtyre rreziqeve.

KREU IV

MBROJTJA E MJEDISIT DHE ADMINISTRIMI I MBETJEVE

Neni 23

Marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit

Kontraktori gjatë zbatimit të projektit duhet të ketë si qëllim kryesor mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut.

- a. Masat për mbrojtjen e mjedisit duhet të zbatohen nga Kontraktori gjatë gjithë

fazave të zbatimit të punimeve të ndërtimit, në mënyrë që të parandalohen apo të



[Handwritten signature]

- minimizohen efektet negative te veprimtarise ndertimore ne ngjarje.
- a. Gjate procesit te germimeve, kontraktori duhet te marre masa te vecanta per mbrojtjen e tokës, qe përfshin ruajtjen e cilësive dhe të funksioneve natyrore të tokës, parandalimin e dëmtimit të saj, si dhe përmirësimin dhe rehabilitimin e tokës së dëmtuar.
 - b. Kontraktori duhet te zbatoje te gjithë kerkesat teknike lidhur me masat per mbrojtjen e bimesise, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujqor(*rrjedhave dhe burimeve ujore*), të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshem/përhershëm.

Neni 24

Kompensimi i demeve

Kontraktori është i detyruar qe të kompensojë me shpenzimet e tij marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese, për dëmet që ai ka shkaktuar në mjedis, lidhur me:

- a. Rikthimin e mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme.
- b. Kompensimin e dëmit të shkaktuar në mjedis.

Neni 25

Administrimi i materialeve dhe mbetjeve

Kontraktori duhet te synoje ne marrjen masave lidhur me mbrojtjen e mjedisit persa i perket ndotjes dhe dëmtimit prej mbetjeve te ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor te tyre ne çdo faze, përfshi krijimin, grumbullimin, transportin, ne nje vend te vecante me qellim te zvogëlimit te ndikimit te tyre.

- a. Kontraktori gjate zbatimit te fazave te punimeve, duhet te marre te gjitha masat per transportin e mbetjeve të ndërtimit ne zonen e depozitimit te tyre që gjenerohen nga ndertimi i objektit.
- b. Transportimi i mbetjeve të ndërtimit, nga objekti per ne zonen e depozitimit duhet te kryhet në mënyrën më të sigurtë dhe me shqetësim sa më të vogël për zonat e banimit që ndodhen përgjatë segmentit rrugor.
- c. Mjetet që përdoren për transportimin e mbetjeve, nuk duhet te ndotin zonen gjate transportimit te tyre, duke synuar parandalimin ose reduktimin e mbetjeve dhe ndikimeve të dëmshme të tyre mbi mjedisin.

KREU V

KANTIERI I NDERTIMIT

Neni 26

Ngritja e kantierit te ndertimit

Për zbatimin e punimeve të ndërtim-montimit, në sheshin e liruar të ndërtimit ngrihet, përkohësisht, kantieri i punimeve, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në projekt-organizim.

- a. Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga Kontraktori ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që

emërohen prej tij.



[Handwritten signature] 9

- b. Rrethimi i kantierit bëhet në përputhje me rregullat dhe kerkesat teknike.
- c. Në nje vend të dukshem në kantier, Kontraktori do te vendos tabelen e identifikimit të punimeve me të dhënat për objektin qe ndertohet, destinacionin, investitorin, subjektin projektues e mbikëqyrës dhe afatet e realizimit te punimeve.

Neni 27

Detyrimet e kontraktorit

Kontraktori detyrohet të sigurojë në kantier:

- a. Nje staf tekniko-profesional të aftë dhe te kualifikuar, me nje instruktim teknik per mbrojtjen e shendetit ne pune.
- b. Materiale, pajisje, mjete mbrojtëse, kolektive e individuale, si dhe tabela paralajmëruese te sinjalistikes rrugore dhe sigurimit teknik.
- c. Mirëmbajtjen dhe kontrollin periodik të makinerive e të mekanizmave të instaluara në objekt, për punë pa rrezik.
- d. Rregullore, urdhra e udhëzime, për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë.
- e. Librin e instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë të punëmarrësve.

Neni 28

Detyrat e pergjegjesit teknik te kantierit

Përgjegjësi teknik i kantierit ka këto të drejta dhe detyra:

- a. Të instruktojë/riinstruktojë punonjësit, në përputhje me programin e punës.
- b. Të instruktojë, veçanërisht, punonjësit e rinj, që fillojnë punë për herë të parë, skuadrat e individëve, që vijnë rishtaz në kantier, që fillojnë një proces të ri pune apo që vendosen në punime të veçanta me shkallë vështirësie.
- c. Të largojë menjëherë nga puna çdo punëmarrës, që nuk zbaton masat e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë, si dhe të pezullojë punën kur nuk garantohen masat mbrojtëse
- d. Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe të mekanizmave nga manovratorë të paafte dhe te cilet nuk jane te pajisur me deshmi perkatese.
- e. Jo më vonë se 3 (tre) ditë pas nënshkrimit të proces-verbalit të kolaudimit, te heq ndërtimet e përkohshme dhe te realizoje punimet përfundimtare të sistemimit.

KREU VI

DOKUMENTACIONI TEKNIK I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Neni 29

Hartimi idokumentacionit

Gjate zbatimit te punimeve, ne kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, qe verteton kontrollin e vazhduar, saktesine dhe cilesine e punimeve, i cili permban:

- a. Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit e të rrjeteve të infrastrukturës, për lidhjen e themeleve e të bazamenteve me tabanin, për kontrollin në plan e lartësi të objektit, të strukturave mbajtëse etj.
- b. Dokumentacionin teknik për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të strukturave,



Handwritten signature

1. AK-ja mund të terhiqet nga kontrata ne rastin kur kontraktori shkel dispozitat e kontrates dhe arrihet ne perfundimin se ai nuk eshte ne gjendje qe te permbushe detyrimet kontraktore.
2. Zgjidhja e kontrates behet vetem me shkrim dhe konform dispozitave te percaktuara ne Kodin Civil te Republikes se Shqiperise.
3. Mos-marreveshjet qe mund te lindin midis paleve gjate zbatimit te kesaj kontrate do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert secila pale ka te drejte t'i drejtohet juridiksionit gjyqesor per zgjidhjen e konfliktit.

Neni 34

Detyrime kundrejt financuesit

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi marrin masa që gjatë realizimit të punimeve në objekt do të vendoset një tabelë treguese në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, e cila vë në dukje se punimet po kryhen me mbështetjen financiare të qeverisë zvicerane. Të dhënat e përfshira në tabelën treguese për këtë element do të jepen nga DLDP, sipas rregullave të vizibilitetit të zbatuara nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.

AK-ja dhe Kontraktori nuk do të ngarkojnë me përgjegjësi as DLDP apo HSI dhe as SDC apo Ambasadën e Zvicrës për çdo lloj pretendimi që mund të ngrenë palët gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, apo që mund të rrjedhë nga zbatimi i kësaj Kontrate.

Neni 35

Dorezimi i objektit dhe dokumentacionit

Autoriteti Kontraktor te veje ne dispozicion te Kontraktorit objektin ku do te kryhen punimet si dhe dokumentacionin teknik perkates per rikonstruksionin e tij. Dorezimi i punimeve do te behet me firmosjen e aktit perfundimtar (situacionit), i cili ka te bashkelidhur gjithe dokumentacionin ligjor.

Neni 36

Hyrja ne fuqi e kontrates

Kontrata hyn ne fuqi pasi te jene plotesuar keto kushte:

- a. Kontraktore kete ngurtesuar nje Sigurim Kontrate ne shumen 10 % te çmimit te kontrates prane Kompanise se Sigurimit/Bankes.
- b. Kontrata te jete nenshkruar nga perfaqesuesit e autorizuar te seciles pale.

Kjo kontrate u hartua ne 4 (kater) kopje, dhe pasi u lexua u nenshkrua nga te dyja palët kontraktore me vullnetin e tyre te lire dhe te plote.

PER PALET KONTRAKTORE

PER SUBJEKTIN "GPG COMPANY" sh.p.k

PER BASHKINE KUKES

DREJTUESI LIGJOR
Paqsor BUZI

Paqsor Buzi

KRYETARI
Bashkim SHEHU

Bashkim Shehu

